REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 233/22
Datë/Datum. 11.08.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

PSH.nr 233/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej z. Vedat Poterqoi- Kryetar, znj. Nita Bejta- Anëtare, znj. Vjosa Gradinaj Mexhuani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: NTSH "Dardani"- Kaçanik, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit: "Shitja e masës drunore sipas planit operativ 2022 për Lot 2" me nr. prokurimi: 625-22-036-2610 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Komuna e Kacanikut, më datën: 11. 08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet** pajtimi i palëve për ankesën 233/22 të datës 27. 06. 2022 lidhur "Shitja e masës drunore sipas planit operativ 2022 për Lot 2" me nr. prokurimi: 625-22-036-2610 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Komuna e Kaçanikut.

II. **OBLIGOHET** AK- KK Kaçanik aktivitetin e prokurimit "Shitja e masës drunore sipas planit operativ 2022 për Lot 2" me nr. prokurimi: 625-22-036-2610 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Komuna e Kacanikut, konform raportit të ekspertit shqyrtues me të cilin AK është pajtuar ta kthejë në **RIVLERËSIM.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se OE ankues është pajtuar me rivlerësim të aktivitetit të prokurimit dhe sipas raportit të ekspertit ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Me datën: 27. 06. 2022, OE ankues NTSH "Dardani"- Kaçanik, si palë e pakënaqur ka parashtruar ankesë me nr: 233/22, LOT -2, kundër propozimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik Metë Muriqi B.I (NTP "Dromodoli Comerc") për LOT-2., lidhur me aktivitetin e prokurimit: *"Shitja e masës drusore sipas planit operativ 2022" me nr. të prokurimit:* KA652/22/036/2610, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna – Kaçanik.

OE ankues në ankesë pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, siç janë:

- Neni 7, dhe 59 të LPP-së, si dhe
- U.A. me nr. 15/2006 për standardet dhe kushtet për licencimin e përpunuesve të produkteve drunore.
- U.A. me nr. 03/2008 për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për dhënien e licencave për kryerjen e punimeve në pyje dhe toka pyjore.
- U.A. me nr. 06/2010 për mënyrën dhe procedurat e shitjes se trungjeve pyjore dhe asortimenteve drusore nga pyjet publike.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 28. 06. 2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 01. 07. 2022, në raportin e ekspertizës ka deklaruar:
Sqarim hyrës: Autoriteti kontraktues Komuna – Kaçanik, ka zhvilluar procedurë te hapur, lloji i kontratës Ankand publik, kriteri i dhënies – çmimi me i lartë. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës. Gjithashtu, sqarojmë se ankesa nuk është e ngarkuar në platformën e-prokurimit, por është pranuar si kopje fizike pran OSHP-së, ndërsa dosja e tenderit dhe njoftimet tjera, ofertat janë të ngarkuara ne sistemin e prokurimit. AK në DT ka përcaktuar kriteret e dhënies së kontratës, ku gjatë trajtimit të kësaj ankese, do të paraqiten këto kritere të dosjes së tenderit.

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) NTSH "Dardani"- Kaçanik
Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik ankues NTSH "Dardani"- Kaçanik, pretendon se AK ka bërë diskriminim në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së sepse AK ka shpërblyer me kontratë OE i cili ka qenë i dënuar nga Gjykata kompetente për dëme pyjore e cila ceket në vërtetimin e APK-s, dhe pretendon se AK ka kërkuar vërtetimin nga APK që nuk duhet të kenë dënime dhe atë vërtetim të kompanisë "Dromodoli Comerc" ceket qartë se ka qene i dënuar për dëme pyjore. Tutje, OE ankues pretendon se AK ka kërkuar sqarim nga Inspektorati Qendror i Kosovës, ku në përgjigje specifikon: CITIM-me anë të secilës ja kemi konfirmuar se jo vetëm qe ka procedurë te iniciuar por kemi edhe Aktgjykim te Gjykatës me dënim që ka vërtetuar procedurën tonë, ku

keni faktet edhe të dy vërtetimeve të ndryshme nga APK-ja (me datën 16.06.2021 ka marr një vërtetim se nuk ka dënime për vazhdimin e licencës, ndërsa me datën 04.05.2022 ka marr vërtetimin se kompania ne fjalë ka pas dënime dhe të Formës së prere. OE ankues në vazhdim të pretendimit cek AK veçanërisht APK ka të hartuar Udhëzime Administrative ku janë të parapara sanksionet për kompanitë të cilat ka kallëzime penale e ne veçanti rasti i OE "Dromodoli Comerc" ka dhe Aktgjykim të prerë nga gjykata kompetente dhe cilat janë masat që janë ndërmarr për këtë OE që parashihen me Udhëzime Administrative ku janë të parapara sanksionet për kompanitë të cilat ka kallëzime penale e në veçanti rasti i OE "Dromodoli Comerc" ka dhe Aktgjykim të prerë nga gjykata kompetente dhe cilat janë masat qe janë ndërmarr për këtë OE që parashihen me Udhëzim Administrativ me **nr.15/2006** neni 15 Licenca mund ti hiqet personit (subjektit) nëse vepron në kundërshtim me ligjin dhe kushtet e licencës dhe Udhëzim Administrativ me **nr.30/2008** neni 11 Citon "Departamenti i Pylltarisë mbi bazën e provave të vërtetuara nga inspeksioni i pylltarisë organi kompetent menaxhues me pyjet dhe organe tjera kompetente ia heq të drejtën e përdorimit të licencave për një periudhe prej 2 deri në 5 vjet, subjekteve juridike nëse:

a) Me veprimtarinë e tyre kanë shkaktuar dëme ose kundërvajtje në pyje;
b) Janë shkaktarë të mos shlyerjes së detyrimeve kontraktuese gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre dhe
c) Gjatë zhvillimit të aktivitetit me veprimin ose mosveprimin e tyre shkaktojnë shkelje te këtij Udhëzim Administrativ dhe dispozitave ligjore në fuqi.

Ekspertja shqyrtuese për këtë pretendim sqaron se AK në dosje të tenderit ka kërkuar:

Kriteret e Dhënies	21.1	*[Dhënia e kontratës do të bazohet në çmim me i lartë dhe në faktorët në vijim]* *[shëno faktorët]* 1.Regjistrimi i biznesit me shifrat e veprimtarisë. Përkatëse 2. Çert. e nr. fiskalë nëse nuk është ne cerrt. e biznesit. (kopje) 3. Çert. e TVSH-se. (kopje) 4.Licenca për eksploatimin e pyjeve -valide. (kopje) 5. Dëshmia nga Gjykata kompetentë se nuk është në procedurë te ndjekjes të prerjes ilegale te pyjeve apo transport ilegal. 6. Dëshmi nga DBZHRP-je (sektori i pylltarisë Kaçanik) se kundër subjektit përkatës nuk ka te ngritur procedurë për dëme pyjore dhe se nuk ka obligime te pa kryera nga kontratat e mëparme. **7. Dëshmi nga APK-Inspektorati qendror i Kosovës se kundër subjektit përkatës dhe Menagjerit nuk ka te ngritur procedurë për dëme pyjore.** 8.Planik dinamik. Jo më shumë se 40 ditë pune për secilin LOT. 9.Nji Ingjinjer apo teknik i pylltarisë me dëshmitë Diploma-kopje, Kontrata e punës, CV). 10.Specifikacioni për Mekanizmin në dispozicion së paku prej -a)traktor për tërheqje se paku dy. b) kamion transportues se paku 2, c)sharra motorrike se paku 2. LOT 1 -Lista e projekteve nga lëmia e shfrytëzimit të pyjeve së paku në vlerë min. 43.000,00€ të realizuara në trevjeshin e fundit.(Kontratat dhe referencat). LOT 2 -Lista e projekteve nga lëmia e shfrytëzimit të pyjeve së paku në vlerë min. 69.000,00€ të realizuara në trevjeshin e fundit.(Kontratat dhe referencat).

Pra, në pikën 7 te Kriteret e Dhënies (në dosje të tenderit), AK ka kërkuar *"Dëshmi nga APK-Inspektorati Qendror i Kosovës se kundër subjektit përkatës dhe Menagjerit nuk ka të ngritur procedurë për dëme pyjore."* Për këtë kërkesë, OE i rekomanduar me tender ka bashkangjitur dokumentin me titull "Vërtetim APK- ja pdf", të lëshuara nga Agjencia Pyjore e Kosovës (APK), dokumentin me numër të protokollit 1764 me numër të referencës APK-DL-103/2022 të datës 04.05.2022, ku thuhet se OE N.T.P. "Dromodoli Comerc" vërtetohet se OE i lartcekur nuk figuron si debitor dhe nuk ka obligime financiare ndaj APK-së. Po ashtu në këtë dokument ceket "referuar konfirmimeve të Inspektorëve dhe të dhënave të krahasuara me librin e protokollit i njëjti ka pasur të ngritur një fletë paraqitje kundërvajtje me datë 18.05.2019 nga inspektorati por i njëjti sipas Aktgjykimit me nr.292/19 dt. 9.07.2019 i ka kryer të gjitha obligimet dhe e njëjta nuk përbën pengesë administrative për këtë procedurë. Po ashtu në këtë dokument APK cek: Vërtetimi i lëshohet vetëm për aplikim në procedurë të ankandit publik në

APK dhe për qëllime tjera nuk mund të përdoret.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK gjatë ri vlerësimit duhet të kërkoj sqarime shtesë nga AKP duke kërkuar aktgjykimin Nr. 292/2019 të datës 29.07.2019 dhe të vlerësoj sipas Aktgjykimit nëse OE i rekomanduar është i përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së. Andaj pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm.

Sqarojmë se ne ankesën e dorëzuar nga OE ankues NTSH "Dardani"- Kaçanik, është bashkangjitur shkresa me numër 2629 dhe numër reference KE-436/21 të datës 16.06.2021, lëshuara nga Agjencia Pyjore e Kosovës (APK),në të cilin dokument ceket se OE N.T.P. Dromodoli Comerce" Metë Muriqi B.I. nuk figuron si debitor dhe nuk ka obligime financiare ndaj APK-së. Po ashtu në këtë dokument APK cek: *Ky vërtetim vlen për vazhdim të Licencës sipas kërkesës së palës dhe i njëjti nuk mund të përdoret për çështje tjera.* OE ankues në ankesë potencon se AK ka kërkuar vërtetimin nga APK, përkatësisht Inspektorati i Kosovës me ç'rast OE Dromodoli ka sjellë vërtetimin nga APK, ku ceket se OE në fjalë ka pasur të ngritur fletëparaqitje, ku nga zyrtari i përgjegjës që lëshon vërtetimin është cekur që kjo procedura nuk bën shkelje ligjore, i njëjti zyrtar në vitin 2021 e fsheh dënimin dhe lëshon vërtetimin për licencim duke cekur që OE nuk ka dënim ndërsa në vitin 2022 e cek që ka pas dënim por nuk bënë shkelje dhe nuk i pengon për pjesëmarrje në ankandet publike. Këtu ka vend edhe për krime ekonomike. Ekspertja shqyrtuese sqaron se lëshimi i vërtetimeve të tilla është në përgjegjësi të APK-së dhe nuk është në mandatin e ekspertit që të shqyrtoj procedurën e lëshimit të vërtetimeve të tilla. Në rast se OE ankues ka dyshime se ka shkelje me rastin e lëshimit të vërtetimeve dhe fshehje të dënimit nga APK, atëherë duhet ti drejtohet organeve kompetente. Megjithatë, AK-Komuna-Kaçanik, gjatë rivlerësimit duhet të sqarojë Aktgjykimi me nr.292/19 i dt. 09.07.2019, ashtu siç është cekur më lartë në lidhje me pretendimin që ka të bëjë me pranueshmërinë e kandidatëve ose tenderuesve sipas nenit 65 të LPP-së.

Sqarojmë se OE i rekomanduar me rastin e ofertimit ka dorëzuar Licencën e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Departamenti i Pylltarisë - Për shfrytëzimin e qëndrueshëm të pyjeve me nr. 28/2021 në emër të biznesit me numër 810403337 – Metë Muriqi me datë të lëshimit 16.06.2021 me vlefshmëri deri me dt 16.06.2026.

Pretendimi tjetër i OE ankues ka të bëjë me dokumentacionin e OE "Dromodoli Comerc", ku në ankesë potencon shifet se në listën e Mjeteve themelore ka të cekura dy traktor të marr me qira nga një OE tjetër i cili nuk posedon dokumentacion që përmban në emrin e tij, nuk posedon as librezë të qarkullimit të traktorëve sipas mendimit tonë jo valide.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK te pika 10 e Kritereve për Dhënie ka kërkuar: 10. Specifikacioni për Mekanizmin në dispozicion së paku prej

a) traktor për tërheqje së paku dy.

b) kamion transportues së paku 2,

c) sharra motorrike së paku 2.

OE i rekomanduar për kontratë ka bashkangjitur dokumentin me titull "Lista e pajisjeve.pdf", ku në këtë dokument janë gjithsejt 7 mjete dhe 3 sharra. Ankuesi potencon se dy traktor të marr me qira nga një OE tjetër i cili nuk posedon dokumentacion që përmban në emrin e tij dhe nuk posedon as librezë dhe nuk janë valide, ekspertja shqyrtuese sqaron se në këtë dokument janë 2 traktor, ku në listën e pajisjeve me numër rendor 6 është traktori me markë dhe tip "Case International 4230" i vitit 1994 me ngjyrë të kuqe/zezë dhe me numër serik 4230AXLIJE0901371, kurse në listën e pajisjeve me numër rendor 7 është traktori me markë dhe tip "Massey Ferguson (GB) FE35" i vitit 1981, me ngjyrë të kuqe/hirit me numër serik SNMY290256. Për këta dy traktor, OE i rekomanduar ka bashkangjitur si dëshmi kontratën mbi qiranë e lidhur mne 06.05.2022 ndërmjet N.T.P. "Dromodoli Comerc" nga Peja në cilësinë e qira marrësit dhe "Joos Krasniqi – Baze" Sh.p.k. në cilësinë e qiradhënësit. Në këtë kontratë janë dhënë specifikat e mjeteve, me specifikat e cekura si më lartë. Pretendimi i ankuesit është se dy traktor të marr me qira nga një OE tjetër i cili nuk posedon dokumentacion që përmban në emrin e tij dhe nuk posedon as librezë dhe nuk janë valide, ekspertja shqyrtuese sqaron se në faqe 11 të dokumentit me titull "Lista e pajisjeve.pdf" gjendet fatura 16-SHV01-002-9 e lëshuar nga N.P.T. "NOLI" si shitës, kurse Joss&Krasniqi –Bazë Sh.p.k. si blerës i traktorit Case Internation 4230, ku vlera e faturës është 15,500. faqe 12 të këtij dokumenti është bashkangjitur edhe dokumenti unik doganor i lëshuar në emër të N.P.T. "NOLI" me rastin e importit të këtij traktori. Po ashtu ne faqe 14 të dokumentit "Lista e pajisjeve.pdf" është edhe fatura për traktorin Massey Ferguson (GB) Fe, ku blerës është Joss&Krasniqi-Baze Sh.p.k. dhe shitës N.P.T. "NOLI" sipas faturës 16-SHV01-001-54 me vlerë 3,000.00 euro. Po ashtu te dokumenti lista e pajisjeve në faqe 15 gjendet dokumenti unik doganor në emër të importit nga N.P.T. NOLI me rastin e importit të këtij traktori.

Sqarojmë se OE i rekomanduar posedon kontratë mbi marrjen me qira të këtyre dy traktorëve, në shkresa gjenden DUD-at doganor dhe faturat e blerjes nga dhënësi me qira i traktorëve. Andaj pretendimi është i pa qëndrueshëm.

Pika tjetër ankimore e OE ankues është: gabimet që kemi parë në dokumentacionin e OE "Dromodoli Comerc" në dëshmi nga DBZHRP-je komunale kemi hasur në nr. e biznesit 80237707 ku te deklaruar ka tatimet 00.00 e që nuk përputhen me nr. e biznesit që posedon në Licencë.

Për këtë pretendim ankimor, **ekspertja shqyrtuese sqaron** se ARBK me datë 23.04.2019 ka lëshuar njoftimin në faqen zyrtare se duke u bazuar në zbatim të Ligjit Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare - Numrin Unik Identifikues (NUI) dhe implementimi i platformës se re për regjistrimin e bizneseve në ARBK, ju njoftojmë se Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) nga data 11 Shkurt 2019 ka lansuar platformën e re elektronike për regjistrimin online të bizneseve, përmes sistemit ju mund të aplikoni për regjistrimin e bizneseve, kërkesa për ndryshim dhe shërbime të tjera. Për të hyrë në sistem ju kërkohet që paraprakisht të keni llogari të konfirmuar në sistem.

Gjithashtu edhe Administrata Tatimore e Kosovës ka lëshuar njoftim në lidhje me numrin unik identifikues si më poshtë:

Administrata Tatimore e Kosovës, ju njofton se të gjitha shënimet e regjistrimit duke përfshirë deklarimin, arkën fiskale dhe numrin e TVSH mbeten të vlefshme deri në konsolidimin në NUI. Për çdo informate shtesë ju lutem drejtohuni pranë Zyrave Rajonale të Administratës Tatimore.

Pra NUI (numri unik identifikues) është numri i regjistrimit të biznesit i lëshuar nga ARBK dhe NUI është i vlefshëm për identifikimin e Shoqërisë Tregtare për këto qëllime:

•Regjistrimi në regjistër të ARBK;

•Detyrimet tatimore dhe doganore,

•Kontributet pensionale,

•Sigurimet shëndetësore,

•Për autoritetet e inspektimit të marrëdhënieve të punës,

•Si dhe për çdo qëllim tjetër të përcaktuar me ligj.

Ekspertja sqaron se edhe nëse kërkojmë në ARBK me NUI 810403337 të OE "Dromodoli Comerce" dalin shënimet apo të dhënat e njëjta sikurse në shkresa.

Po ashtu në faqe 2 të dokumentit me titull "certifikata e biznesit, fiskal, tvsh.pdf" dorëzuar me rastin e ofertimit, ceket:

që operatori ekonomik i cili rekomandohet për kontratë ti plotësoj kërkesat e specifikuara në nenin 65 të LPP-së.

Provë: bashkangjitur me raport gjeni kopje :

Vërtetimin Agjencia Pyjore e Kosovës (APK), me numër të protokollit.1764 me numër të referencës APK-DL-103/2022 të datës 04.05.2022 dhe Licencën e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Departamenti i Pylltarisë nr. 28/2021.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës, si dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 04 korrik 2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues Komuna e Kaçanikut me datën 07 korrik 2022 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së.

Operatori ekonomik ankues "NTSH Dardani" me datën 07 korrik 2022 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, deklarimeve të palëve se pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues për rivlerësim të aktivitetit të prokurimit deklaron se procedura e shqyrtimit të ankesës përfundon në këtë fazë, ndërkaq obligohet Autoriteti Kontraktues KK Kaçanik që aktivitetin e prokurimit ta rivlerësoj sipas mendimit të ekspertit shqyrtues dhe brenda afatit 10 ditor konform LPP-së ta njoftoj panelin shqyrtues me veprimet e ndërmarra.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryetar i PSH-së

z. Vedat Poterqoi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- KK Kacanik

1x1 OE "NTSH Dardani"

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.